Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0550

OSHP: 2023/0552

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e amandamentuar me datën 09. 08. 2023, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Q.M. "Tema", si dhe OE "Gent Gorani" B.I, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të Telekomi i Kosovës Sh.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio" me numër të prokurimit TK-23-4036-1-2-1, me 27/11/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE Q.M. "Tema" me nr. 2023/0550, e datës 07/08/2023, si dhe ankesa e OE "Gent Gorani" B.I me numër 2023/0552 e datës 07/08/2023, kurse vendimi i AK Telekomi i Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio" me numër të prokurimit TK-23-4036-1-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Q.M. "Tema" dhe OE "Gent Gorani".

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.05.2023, Telekomi i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio" me numër të prokurimit TK-23-4036-1-2-1. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 116,440.00 €.

Me datën 20. 07. 2023, AK Telekomi i Kosovës, ka publikuar njoftimin B58 për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar OE Manag& Development Associates" LLC.

Me datën 25.07.2023, OE "Gent Gorani" B.I ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27.07.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim. Poashtu, me datën 25. 07. 2023, ne AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim edhe OE Q.M "Tema", të cilën e ka refuzuar autoriteti kontraktues me datën 27. 07. 2023.

Me 07.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën Q.M. "Tema"me nr. protokolli 550/23 lidhur me aktivitetin "Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio" me nr. të prokurimit: "TK-23-4036-1-2-1".

Me 07.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën "Gent Gorani" B.Ime nr. protokolli 552/23 për aktivitetin "Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio" me nr. të prokurimit: "TK-23-4036-1-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Q.M "Tema"janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi* Shkelja e Nenit 28 të LPP-së- Autoriteti Kontraktues "Telekomi i Kosovës" SH.A. (më tutje AK) në pikën 3.1 të FDT-së, ka vendosur në mënyrë të gabuar kërkesë që operatorët ekonomik pjesëmarrës ta dorëzojnë dokumentacionin e tenderit duke bashkangjitur edhe një "deklaratë për specifikacionet teknike të mallrave të ofruara". Kjo kërkesë e AK bie në kundërshtim me llojin e kontratës, sepse aktiviteti i prokurimit me nr. TK-23-4036-1- 2-1 është një kontratë kornizë e shërbimeve. Gjatë fazës së vlerësimit, AK përmes letrës standarde B42 të publikuar më 20 Korrik 2023 ka njoftuar se ka eliminuar kompaninë tonë dhe shumicën e ofertuesve të tjerë të cilët nuk e dorëzuan këtë deklaratë, me arsyetimin për mospërmbushje të kërkesës administrative nga pika 3.1 e FDT-së. Në arsyetimin AK thuhet: *"Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ofertës tuaj i mungon dokumenti "Deklarata për Përputhshmëri Teknike sipas kërkesave të Nenit 3.1 të FDT dhe rrjedhimisht nuk i plotësoni kërkesat lidhur me përshtatshmërinë administrative".* Nëse i referohemi titullit të tenderit "Krijimi dhe realizimi i reklamave për TV dhe Radio" dhe llojit të deklaruar te prokurimit në titull të kontratës - shërbime, mund të shihet se me këtë aktivitet

të prokurimit AK ka për qëllim lidhjen e një kontrate kornizë të shërbimeve për prodhim të veprave audiovizuale - komunikimeve komerciale, apo siç njihen në publik, të reklamave për TV dhe Radio. Mirëpo, AK ka kërkuar në pikën 3.1 të FDT – "Specifikacionet teknike të detyrueshme" që tenderuesit të dorëzojnë një Deklaratë të përmbushjes së specifikacionit teknik të mallrave, që është një kërkesë në kundërshtim me llojin e prokurimit. Në tabelën e FDT -së tek pika 3.1 e kërkesave figuron "a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit".AK ka vendosur një kërkesë administrative e cila përdoret tek kontratat për furnizime, dhe si e tillë është kërkesë e palejuar në këtë procedurë, sepse nuk është në përputhje me lëndën dhe qëllimin e këtij aktiviteti - prokurimin e shërbimeve audiovizuele. Duke e vendosur në pikën 3.1 të FDT-së një kërkesë për deklaratë të konformimtetit me specifikacion të mallrave në një kontratë të llojit 2 - Shërbime (kontratë jo e përzier, në kuptimin e klasifikimit sipas Nenit 15 të LPP), AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 28.2 të LPP- së.Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Neni 28, pika 2"*Autoriteti kontraktues do ti përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik*". Ngjashëm, edhe Rregullorja Nr.001_2022 për Prokurimin publik në Nenin 25.6, edhe Udhëzuesi Nr. 001-2023 (A2) i KRPP-së në pikën 8.3 kërkojnë që kërkesat minimale për kualifikim (respektivisht kriteret e përzgjedhjes) të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit:Rregullorja Nr.001_2022 për Prokurimin Publik, Neni 25.6. Udhëzuesi Nr. 001-2023 (A2), pika 8.3*: "Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë."*AK ka vendosur në pikën 3.1 të FDT të kontratës për shërbime një kërkese minimale për kualifikim e cila është jorelevante dhe e pabazuar në ligj, e cila ka shkaktuar paqartësi tek OE Q.M. "TEMA" O.P. për lëndën kryesore të kontratës. Ky OE nuk e ka dorëzuar një dëshmi të tillë në sistemin E-prokurimi gjatë fazës së dorëzimit të tenderëve, me bindjen se AK ka bërë një lëshim teknik në përpilim të DT, sepse furnizimi i mallrave nuk është objekt i kësaj kontrate. Gjatë përgatitjes së dokumentacionit tenderues, Q.M. "TEMA" O.P. nuk ka gjetur në Aneksin 1 të DT të ketë të listuar ndonjë "mall" apo "specifikacione teknike për mallrat e ofruara", ashtu siç është kërkuar në pikën 3.1 të FDT-së. Përkundrazi, në Aneksin 1 të DT figuron tabela e shërbimeve të kërkuara me specifikacionet e tyre teknike, mirëpo kërkesa e vendosur në pikën 3.1 të FDT-së është e pazbatueshme për to, Paralelisht me realizimin e video reklamave, animacioneve dhe video+animacion (kombinim), kontraktori obligohet të bëjë fotografi artistike gjate xhirimit te videospotit (rreth 20 foto) me kualitet te lartë, te cilat Telekomi i Kosovës do t'i përdorë për realizimin e dizajnëve per materiale te printuara. Ndërsa me realizimin e animacionit, kontraktori obligohet t'i përcjellë fajllat PNG –JPG qe do te përdoren per realizimin e dizajnëve për materiale te printuara. E njëjta vlen edhe për video+animacion (kombinim), kontraktori obligohet te beje fotografi artistike se paku 10 cope dhe t'i përcjellë fajllat PNG-JPG qe do te përdoren për realizimin e dizajneve për materiale te printuara. Përveç videoreklamave, video+animacioneve, animacioneve me format standart (për TV), kontraktori e merr për obligim qe t'i realizojë edhe ne formatet: Video dhe Image 1080x1080, Video dhe Image 1080x1920 dhe formate te tjera sipas kërkesës për webfaqe/portale. Për të vërtetuar se veprimtaria e prodhimit të përmbajtjeve audivizuele, që është lëndë dhe qëllim i këtij prokurimi, i takon domenit të shërbimeve profesionale dhe jo furnizimeve, i referohemi Ligjit nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, i cili në Nenin 2, pikat 1 dhe 2 i jep definicionet për shërbimin medial audiovizuel

dhe Ofruesin e shërbimit medial: Ligji 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave "*1.1. Shërbimi medial audiovizuel - shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike. 1.2. Ofrues i shërbimit medial - personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuele të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij*.". Prova 2: Ligji 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave. Në DT të këtij Aktiviteti të Prokurimit, në Pjesën A: Procedurat e Tenderimit/ Seksioni I (fq. 3 dhe 4), në rreshtin 3 të tabelës sqaruese (Specifikacionet e Detyrueshme Teknike), figuron kërkesa "3.1 Furnizimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike", me të cilin vërtetohet pretendimi ynë se AK në mënyrë të gabuar ka përdorur pjesë të formularit standard B27 të përcaktuar për Kontratat e Furnizimeve, në një procedurë që ka për qëllim Kontraktimin e Shërbimeve (Formulari standard B28), rrjedhimisht, edhe kërkesa 3.1 në FDT është joadekuate dhe e pazbatueshme, sepse është e paraparë për një kontratë të furnizimeve, dhe si e tillë nuk mund të përdoret si kriter për përzgjedhje në këtë rast. Ky pretendim mund të vërtetohet edhe ne platformën e- prokurimi, ku AK ka klasifikuar gabimisht aktivitetin e prokurimit nr. TK-23-4036-1- 2-1 në llojin e kontratës "Furnizim", në vend se "Shërbime". Formulari zyrtar i B28 që përdoret për prokurim të shërbimeve, në tabelën e FDT nuk a parasheh seksionin 3.1 të kërkesave për specifikacione të detyrueshme teknike për "mallra" ashtu siç ka kërkuar AK në FDT të kësaj procedure.

- Përgjigja e AK lidhur me Shkeljen e Nenit 28 të LPP-së- "Pretendimi ankimor i OE Q.M. "TEMA" O.P. Ferizaj se ka pasur shkelje të Nenit 28 – Specifikacionet Teknike nuk qëndron për faktin se Autoriteti Kontraktues ka parashtruar me kohë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike te Aneksi 1 ku ka përpiluar specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit" Arsyetimi i AK në këtë pikë është i pabazuar, jorelevant dhe të paqartë, sepse nuk e adreson paqartësinë e kërkesës nga pika 3.1 e FDT-së për deklaratën e konformitetit të mallrave, dhe ndërlidhjen e saj me shërbimet e kërkuara në Aneksin 1, e cila është thelbi i pretendimit tonë për shkeljen ligjore të shkaktuar dhe e cila ishte arsye e eliminimit tone nga tenderi. Në kërkesën tonë për Rishqyrtim asnjëherë nuk e kemi kontestuar përmbajtjen e Specifikacioneve të Detyrueshme Teknike të shërbimeve të listuara në Aneksin 1. Përkundrazi, në kërkesën për rishqyrtim OE Q.M. TEMA O.P. e ka kontestuar kërkesën AK të vendosur në pikën 3.1 të FDT, sepse nuk është në përputhje me llojin dhe qëllimin e kësaj procedure të prokurimit. Në arsyetimin e vet për refuzim të kërkesës sonë për rishqyrtim, AK në këtë pikë ka dështuar të sqarojë se cilat janë mallrat e listuara në Aneksin 1 në këtë kontratë për shërbime, për të cilat është kërkuar Deklarata e përputhshmërisë e vendosur si kërkesë në pikën 3.1 e FDT-së. Duke dhënë përgjigje të paqartë, jo të plotë dhe irelevante lidhur me pretendimin tonë ankimor, AK nuk i ka përmbushur kërkesat e Nenit 108/A i LPP-së në pikën 9 (Arsyetimi i refuzimit) dhe pikën 10.1 (Refuzimi Kërkesës), në mënyrë që të refuzojë kërkesën tonë për rishqyrtim të vendimit të AK.
- *Pretendimi i dytë (II):*Shkelja e Nenit 27 të LPP-se- Duke iu përgjigjur Kërkesës sonë për Rishqyrtim të Vendimit (B58), AK në përgjigjen e datës 27.07.2023 ka shënuar arsyetimin se "AK me kohë ka përcaktuar se rasti në fjalë është Kontratë për Furnizim", duke dhënë sqarime se fjalët "shërbime" në DT dhe në Aneksin 1 "janë lëshime teknike" gjatë përpilimit të dosjes. Me këtë deklarim të AK, vërtetohet pretendimi ynë se AK ka bërë shkelje të Neneve 27 dhe 28 të LPP, sepse ka përdorur procedurë të papërshtatshme me llojin e

kontratës, duke vendosur kërkesë joadekuate dhe të pazbatueshme në pikën 3.1 të FDT-së. Neni 27, LPP – Dosja e tenderit 1. *"Pa marrë parasysh se a kërkohet dosja e tenderit apo jo, furnizimet, shërbimet apo punët sipas kontratës duhet të përshkruhet me anë të fjalorit të përgjithshëm te prokurimit dhe kodeve të duhura. KRPP-ja do të ketë autoritetin për të vendosur rregulla mbi këto çështje."*. Në platformën E-prokurimi, vërehet se për prokurimin Nr. TK-23-4036-1-2-1, AK ka përdorur kodin e gabuar të FPP 25310000-7 ("Film Radiologjik", Lloji: 1. Furnizime), që është në kundërshtim me Nenin 27.3 të LPP-së, pasiqë kjo dispozitë i obligon AK që të përdorin kodet e duhura gjatë inicimit të aktiviteteve të prokurimit.Nëse i referohemi praktikave të kaluara të Autoritetit Kontraktues "Telekomi i Kosovës", SH.A. lidhur me prokurimin e shërbimeve të produksionit të reklamave televizive apo publikimit të tyre, shohim se në procedurën me numër TK 18-068-211 me NJK të publikuar më 22.01.2019, AK ka përdorur kodin e duhur të FPP-së: 74400000-3 (Shërbimet e reklamave të marketingut), që e vërteton pretendimin tonë se në procedurën e tanishme AK ka përzgjedhur llojin e gabuar të kontratës dhe ka vendosur kriter minimal nga prokurimi i furnizimeve në një kontratë shërbimesh, që është kriter i pazbatueshëm. Shkelja e Nenit 108/A të LPP dhe Nenit 59.1 të Rregullores Nr.001/2022 të KRPP. Në Vendimin e AK për Refuzim të kërkesës për Rishqyrtim, tek paragrafi i "Shënim", AK e hedh poshtë kërkesën tonë për rishqyrtim të vendimit si jashtë afatit, duke u thirrur gabimisht në paragrafin inekzistent 1.1 të Nenit 108/A: "Operatori ekonomik ne të gjithë përshkrimin e kërkesës për rishqyrtim i është referuar dokumentit të tenderit respektivisht specifikimeve teknike, për të cilën Autoriteti Kontraktues duke u bazuar në nenin 108/A paragrafi 1.1 konsideron që kërkesa për rishqyrtim sa i përket kësaj pjese është jashtë afatit ligjor". Me këtë veprim, AK ka shkelur të drejtën tonë të kërkesës për rishqyrtim të vendimit të AK-së, sepse AK ka bërë interpretim të gabuar të ligjit të amandamentuar të LPP, duke iu referuar një paragrafi inekzistent 108/1.1. Neni 108/A i LPP e garanton të drejtën tonë që si OE pjesëmarrës të parashtrojmë Kërkesë për Rishqyrtim për cilindo vendim dhe dokument paraprak të procedurës rrjedhëse (përfshirë këtu edhe njoftimin për kontratë dhe DT), dhe se kalimi i afatit për ankesë në dosjen e tenderit nuk e amniston AK që të vazhdojë procedurën e prokurimit me shkelje ligjore që konstatohen gjatë fazës së rishqyrtimit të vendimit, apo gjatë fazës së ankesave në OSHP: Neni 108/A LPP: Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit. Shkelja e Neneve 7 dhe 59 të LPP-së. Në vendimin B58 të datës 20.07.20243 AK ka bërë vlerësim të gabuar, sepse ka eliminuar OE Q.M. "TEMA" O.P nga tenderi pa u plotësuar kërkesat e Nenit 59 të LPP-së, sepse ka marrë për bazë një kërkesë të palejuar në FDT me të cilën e ka eleminuar OE Q.M. "TEMA" O.P nga tenderi si OE të papërgjegjshëm. Në të njëjtën mënyrë janë eliminuar edhe 4 operatorë tjerë ekonomik pjesëmarrës në tender, me po të njëjtën arsyetim, me ç'rast AK ka shkaktuar diskriminim dhe minimizim të konkurrencës së lirë, në kundërshtim me Nenin 7.3 të LPP-së. Shkelja e Nenit 1 të LPP-së-Duke shpërblyer me kontratë një OE që nuk ka ofruar një tender ekonomikisht më të favorshëm, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1.1 të LPP-së, sepse me procedurën e udhëhequr nuk është siguruar shfrytëzim efikas i fondeve publike, që është njëri nga qëllimet esenciale të LPP-së. Shkelja e Nenit 52 të LPP-së dhe Nenit 27.10 të Rregullores 001/2022 te KRPP. Gjatë fazës së vlerësimit të tenderëve kemi pasur dilema rreth artikulimit të kufijve të konvergjencës së kritereve në këtë TEMF, të cilën e kemi

theksuar në kërkesën tonë për rishqyrtim. Pas analizës së mirëfilltë me ekipin tonë të kësaj procedure dhe nënkritereve të përdorura për dhënie, kemi gjetur këto shkelje të LPP: AK "Telekomi i Kosovës" SH.A. në këtë procedurë prokurimi ka vendosur që kriter i dhënies të jetë Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm. Mirëpo në tabelën e vlerësimit të tenderëve janë vendosur këto nënkritere: Çmimi më i ulët (60% e pikëve), Numri i kampanjave të marketingut të realizuara nga OE gjatë tri viteve të fundit (20% e pikëve), Vitet e përvojës së udhëheqësit të ekipit në marketing(10% e pikëve), dhe Numri i kampanjave të udhëheqësit të ekipit gjatë tri viteve të fundit(10% e pikëve). Nënkriteret e përdorura që ndërlidhen me përvojën e kompanisë, apo të personelit janë kritere minimale të kualifikimit, prandaj përdorimi i tyre nga ana e AK si kritere për dhënie është i ndaluar dhe paraqet shkelje të Nenit 52 të LPP-së dhe Nenit 27.10 të Rregullores Nr.001/2022: Neni 52, LPP - Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës "3.Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike. 4. Autoriteti kontraktues duhet të sigurojë që të bëje një dallim të qartë në mes kritereve të paragrafit 3. të këtij neni dhe kritereve të përzgjedhjes në lidhje me aftësitë e përgjithshme profesionale, financiare dhe teknike të themeluara në bazë të nenit 51 të këtij ligji dhe se nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kritereve.". Neni 27.10 i Rregullores 001/2022 te KRPP "Kriteret minimale për kualifikim (kriteret e përzgjedhjes) nuk përdorën si kritere në procesin e dhënies së kontratës. Tenderuesit do të konsiderohen të kenë përmbushur kërkesat minimale në lidhje me kapacitetin e tyre për të përformuar kontratën që do të thotë që kriteret në lidhje me përvojat paraprake dhe historikut të kompanisë nuk do të shihen si kritere në procesin e dhënies së kontratës." Për t'u siguruar se eksiton një shkelje ligjore në këtë pikë, më datë 02.08.2023 OE Q.M. "TEMA" O.P. i ka drejtuar departamentit të Rregullave në KRPP një letër me pyetje lidhur me përdorimin e kritereve të përzgjedhjes në vlerësim të tenderëve të kësaj procedure, mirëpo deri në datën e dorëzimit të kësaj ankese nuk kemi marrë përgjigje nga ky institucion. Mirëpo duke hulumtuar për çështjen në fjalë, kemi hasur në Opinionin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me numër AKK-DPK-DPKPP-03-03/718/16 të datës 08.03.2016 drejtuar AK "Telekomi i Kosovës" SH.A., përkatësisht udhëheqësit të prokurimit z. Fatmir Gjonbalaj, i cili akoma është në detyrë me të njëjtin pozitë. Ky opinion lidhet me prokurimin TK/16/019/211 – shërbime/TEMF, në të cilin AK kishte vendosur kritere minimale të përzgjedhjes si nën kritere të dhënies së tenderit, me ç'rast AKK kishte gjetur se ky veprim ishte ne kundërshtim me Nenin 52 të LPP, dhe RrUOP në fuqi. Ne jemi të bindur se në këtë procedurë kemi përsëritje të së njëjtës shkelje të LPP-së. Nëse i referohemi "Listës së Plotë Standarde të Radhitjes së Tenderëve Sipas Kriterit të Dhënies të TEMF" të plotësuar nga Komisioni Vlerësues i AK, qartë mund të shihet se OE Q.M "TEMA" O.P. i prin listës me pikët e kombinuara nga kriteret e dhënies për Çmimin më të Lirë, Numrin e Kampanjave të OE gjatë tri viteve të fundit, Përvojën e Udhëheqësit të ekipit dhe Numrin e Kampanjave të Udhëheqësit të ekipit gjatë tri viteve të fundit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Gent Gorani" B.Ijanë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I):*Udhëzues Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve. 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së. Lista e çmimeve nuk është plotësuar - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion

të mëtejshëm - Kusht administrativ. 2) Neni 44 Formularët Standard. 44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde. Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet. Pretendimi 1) Operatoret Ekonomik "2B" & "Management & Development Associates LLC" nuk kane plotësuar Formën Standarde - Lista e çmimeve, përkatësisht kolonat: Titulli Prodhues & Shënim Operatori Ekonomik. OE "2B" nuk ka plotësuar kolonën: Titulli Prodhues 7. OE "MDA" nuk ka plotësuar kolonat: Titulli prodhues & Shënim operatori Ekonomik. Ne i rikujtuam AK se Plotësimi i Listës se çmimeve sipas kërkesës se AK është kusht administrativ, dhe mos plotësimi i tyre dërgon OE ne eliminim nga gara. Ne vazhdim gjeni Listën e çmimeve dhe Formularin e tenderit te OE N.SH. "2 B" ku rezulton se OE nuk ka plotësuar kolonën Titulli Prodhues.

- *Pretendimi i dytë (II):* Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; AK ka shkelur dispozitat e lartë cekura, Pasi qe vlerëson si OE te përgjegjshëm këta dy OE te cilët nuk kane përmbushur kushtin administrativ, ne këtë rast plotësimin e formës standarde te Listës se çmimeve sipas kërkesës se AK. AK ne përgjigjen/refuzimin ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim pretendon se Nuk ka qene e nevojshme te plotësohet kjo fushe pasi qe prodhuesi i reklamave është vete Operatori Ekonomik (këtë argument AK e thotë me shume bindje). Mirëpo ky pretendim i AK nuk vlen, pasi qe AK veç e ka vendosur atë kërkesë ne Formularin Standard: Lista e çmimeve dhe OE e ka obligative qe ta plotësojë ose te kërkonte te hiqej kjo kërkesë para datës se hapjes. Për ne është shume e pakuptimte qe AK te thotë për kërkesat e vendosura nga vete ata, se nuk kane qene te nevojshme te plotësohen! Përfundim: Kërkojmë nga OSHP qe te vlerësojë lenden ne tërësi duke konsideruar argumentet e ofruara, dhe ti vlerësojë pretendimet tona si te bazuara.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të gjitha palët procedurale. Për ankesën Nr. 550/23, AK lidhur me mendimin e ekspertit ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet pjesërisht me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Për ankesën Nr. 552/23, AK lidhur me mendimin e ekspertit ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Me tutje, lidhur me pretendimet e OE Q.M. "TEMA" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0550 ka vlerësuar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I):* Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dosjen e tenderit, aneksin 1 te FDT-se, përshkrimin e çmimeve – (Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio) si dhe Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), konkretisht neni 3.1 i FDT-së, AK me rastin e përgatitjes se procedurës ka përdorur gabimisht llojin e kontratës "furnizim" (1-2-1) ne vend se ta përdorë "Shërbime" (2-2-1), duke vepruar ne kundërshtime me nenin 15 par. 2 të LPP-së, po citoj: "*Kontrata që përfshin njëkohësisht furnizimet dhe shërbimet, konsiderohet si kontratë e shërbimeve nëse vlera e parashikuar e shërbimeve e kalon vlerën e parashikuar të furnizimeve. Nëse në kontratë përfshihen dispozitat mbi dërgimin, vendosjen dhe/ose instalimin e furnizimeve përkatëse, vlera e parashikuar e aktiviteteve të tilla përfshihet në vlerësimin e komponentëve të furnizimeve të kontratës së tillë*", sepse analizuar aneksin 1 dhe përshkrimin e çmimeve, kjo kontrate klasifikohet si shërbime dhe AK kërkon/pranon produktin final jo furnizimet qe rrjedhin deri sa te arrihet produkti final, përves kësaj AK ka mundur te kërkoj deklaratë mbi specifikimin teknik tek kërkesat teknike dhe/ose profesionale si kritere te përzgjedhjes, apo ose/dhe ta kërkoj tek specifikimi teknik ne aneksin 1 të FDT-së, apo/ose tek Dokumentet qe përbejnë Tenderin neni 19.1(h) të FDT-së, prandaj AK – Komisioni i vlerësimit kanë mund te veproj sipas nenit 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve*" dhe mos veprim i AK – Komisionit te vlerësimit ka bërë që të shkelet edhe neni 7 par. 2 të LPP-së, po citoj: "*Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik*", sepse për gabimet e AK nuk duhet te pësojnë OE, sepse OE ankues i ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes dhe për një deklaratë tek neni 3.1 i FDT-së te eliminohet OE ankues (ku zakonisht OE i kushtojnë vëmendje kritereve te përzgjedhjes dhe aneksit 1 të FDT-së), prandaj nuk ka arsyeshëmeri logjike dhe ligjore te eliminohet OE ankues, prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pikë janë të qëndrueshëm.
- Gjithashtu, Eksperti shqyrtues sqaron se AK- ZPP ne përgjigjen e dhënë tek refuzimi i kërkesë për rishqyrtim jap ketë shënim po citoj: "*Autoriteti kontraktues ka përcaktuar me kohë që rasti në fjalë është Kontrate për Furnizim dhe te njëjtën dosje e ka përdor ne këtë*

tender, dosja e tenderit e përcaktuar me kohe përmban te gjitha kërkesat dhe specifikat e dosjes se tenderit për furnizim dhe te njëjtën e përcakton dhe krijon edhe vet platforma sipas numrit te dosjes se tenderit TK-23-4036-1-2-1, te cilën e gjeneron ne baze te te dhënave dhe përcaktimit nga Autoriteti Kontraktues. Ndërsa sa i përket fjalës "Shërbime" ne DT (faqja e pare dhe tek përshkrimi i specifikimeve) është lëshuar gabim teknik ku thuhet kontrate kornize për shërbime dhe Llojet e shërbimeve te marketingut dhe i tere dokumenti i referohet Furnizimit", ku AK – ZPP arsyeton se OE ankues nuk ka kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 53 të LPP-së, ku sipas nenit 16.1 te FDT-së ka qene afati ligjore për sqarime shtesë, si dhe nuk ka parashtruar kërkesë për rishtypim sipas neni 108/A par. 1 të LPP-së, mirëpo përveç kësaj AK sipas nenit 17.12 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik , ku thotë: "*Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë*", si dhe duke marr per baze se OE ankues është përgjegjës te analizoj ne tersi dosjen e tenderit si dhe aneksin 1 të FDT-së, dhe me vet faktin qe ka tenderuar ka marr përgjegjësi se do te veproj sipas aneksit 1 të FDT-së, prandaj konsideroj se andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë janë të qëndrueshëm.

- Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 15, 59, 60 të LPP-së, andaj Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.
- Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikase, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Me tutje, lidhur me pretendimet e OE "Gent Gorani B.I"- Prishtinë, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0552 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimet Ankimore - 1, 2 dhe 3: Operatoret Ekonomik "2B" & "Management & Development Associates LLC" nuk kane plotësuar Formën Standarde - Lista e çmimeve , përkatësisht kolonat: Titulli Prodhues & Shënim Operatori Ekonomik. OE "2B" nuk ka plotësuar kolonën: Titulli Prodhues 7: OE "MDA" nuk ka plotësuar kolonat: Titulli prodhues & Shënim operatori Ekonomik.

- *Përgjigje në pretendimin e parë (I), të dytë (II) dhe tretë (III)*: Ne i rikujtuam AK se Plotësimi i Listës se çmimeve sipas kërkesës se AK është kusht administrativ, dhe mos plotësimi i tyre dërgon OE ne eliminim nga gara. Mosplotësimi i formës standarde nga OE i

rekomanduar për kontrate nga AK bazuar sipas kërkesës së AK -se ne formatin e publikuar nga vet AK mund të ketë pasoja për operatorët ekonomikë nga tejkalimi i aplikimit te ligjeve dhe rregulloreve qe e rregullojnë fushën e prokurimit publik ne Kosove. Mosplotësimi ose mos prezantimi i informacionit të pasaktë ose i pa plotësuar siç e kemi ne rasti tone lidhur me plotësimin e Formës standarde - Lista e çmimeve duke u vlerësuar nga AK si OE i përgjegjshëm, përcillet me pasoja për OE te përgjegjshëm me eliminim nga gara. Përmes këtij procesi, AK duhet te trajtoje procesin e vlerësimit ne formën e trajtimit te barabarte për te gjithë OE ne gare dhe të mbikëqyrë se si funksionojnë komisionet bazuar ne kriteret e vena ne fillim te procedurës dhe të sigurojë që operatorët ekonomikë përmbushin rregullat dhe standardet e konkurrencës së ndershme. Kjo duhet te kontribuojë në parandalimin e manipulimit të çmimeve, parandalimin e tejkalimit te kritereve te vena dhe siguron një konkurrencë të shëndetshme dhe të ndershme në treg. Bazuar ne këtë qe u tha me larte , ju kemi referuar edhe Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik dhe Ligjit për Prokurimit Publik, ku shifet se AK ka bere tejkalime te kritereve duke mos marre për baze mungesën e informacioneve ne Formën Standarde - Lista e çmimeve, përkatësisht kolonat: Titulli Prodhues & Shënim Operatori Ekonomik.Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik shpjegon pretendimin ankimor te OE ankues si ne vijim:Neni 19 Specifikimet Teknike- 19.1 Në zbatim të Nenit 28 dhe 29 të LPP, AK do të specifikoj në dosjen e tenderit të gjitha specifikimet teknike të cilat çdo tender duhet ti përmbush, 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm.Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve: 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Neni 44 Formularët Standard: 44.2 "Përdorimi i formularëve standard" do të thotë se dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë të paktën të gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si informacion të detyrueshëm, dhe në përgjithësi të jenë të qartë dhe të kuptueshme për OE të interesuar.Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. 45.18 Autoriteti kontraktues do të vlerësojë nëse tenderët që kanë kaluar testet e nenit 45.17 të Rregullores janë në pajtueshmëri në kushtet teknike, përshkrimin dhe specifikimet e dosjes së tenderit. Një tender, si rregull kryesor, konsiderohet të jetë i përgjegjshëm vetëm në qoftë se është në përputhje me specifikimet teknike të parashtruara në dosjen e tenderit. Procedura për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. 47.23 Autoriteti kontraktues do të vlerësoj që tenderët që kanë përmbushur kërkesat formale respektojnë kushtet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e dosjes së tenderit. Një tender si rregull i zakonshëm konsiderohet të jetë i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtim me të gjitha specifikimet e dosjes së tenderit. Një vlerësim i tillë i përshtatjes teknike do të kryhet duke përdorur formën standarde të vlerësimit të aprovuar nga KRPP. Kreu I Rregullat Për Specifikimet Teknike dhe Dosjen e Tenderit. Neni 27 Dosja e Tenderit 1. Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet aterial të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat 32

ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nën-kontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji. Ky është formati i publikuar nga AK sa i përket tabelës - Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio. Ky është formati i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate ("Manag.&Development Associates" L.L.C) sa i përket tabelës - Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio. Vlera totale e ofertimit është 79,650.00. OE "Manag.&Development Associates" L.L.C. Ky është formati i dorëzuar nga OE ankues ("OE "2B) sa i përket tabelës - Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio. Vlera totale e ofertimit është 98,471.00 - "OE "2B. Ky është formati i dorëzuar nga OE ankues ("OE "Gent Gorani"- Prishtinë) sa i përket tabelës - Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio. Vlera totale e ofertimit është 88,902.91 - "OE "Gent Gorani"- Prishtinë. Në rastet kur oferta e operatorit ekonomik nuk përmban të dhënat e kërkuara sipas specifikimeve teknike të dhëna nga autoriteti kontraktues, mund të ketë pasoja për procesin e vlerësimit ne dem te OE te eliminuar te cilët i plotësojnë kriteret sipas DT. Mosplotësimi i kushteve teknike dhe Formularit standard - Lista e çmimeve sipas specifikimeve konsiderohet si një mosplotësim i kërkesave të dosjes se tenderit dhe ndikon negativisht në vlerësimin e ofertës nga OE te eliminuar nga AK. Ky tejkalim gjate vlerësimit nga komisioni vlerësues dërgon në diskualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankues nga gara ose vlerësimin e tyre si ofertë jo e suksesshme.Për të qenë konkurrues në një procedurë të prokurimit publik, operatorët ekonomikë duhet të sigurohen që të plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara dhe të prezantojnë një ofertë të plotë dhe të rregullt në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktues. Ky proces duhet të sigurojë transparencën dhe konkurrencën e ndershme dhe do të ndihmojë në sigurimin e një zgjedhjeje sa më të mirë për autoritetin kontraktues.Si ekspert shqyrtues, duke u bazuar në informacionet e mësipërme dhe për faktin se operatori ekonomik ankues ka përmbushur kushtet sipas specifikimeve teknike, këshilloj që paneli shqyrtues të aprovoje ankesën e operatorit ekonomik ankues si e bazuar. Kjo do të thotë se ankesa ka arsye të vlefshme dhe meriton të shqyrtohet më tej.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorëve ekonomik ankues OE Q.M "Tema" dhe "Gent Gorani" B.I. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumentet e tjera. Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorëve Ekonomik duhet të aprovohen si e të bazuara.

Paneli shqyrtues në vlerësimin e tij të pavarur konstaton se lënda të kthehet në rivlerësim, ku operatorët ekonomikë do të kenë mundësinë të përfshihen përsëri ne rivlerësim nga AK duke i vlerësuar drejte dhe pa diskriminim OE te cilët i plotësojnë kriteret bazuar në përshtatshmërinë me kushtet e tenderit. Ky rivlerësim do të sigurojë një konkurrencë të ndershme dhe të barabartë midis operatorëve dhe do të lejojë autoritetin kontraktues të bëjë një zgjedhje sa më të mirë në bazë të ofertave të paraqitura.

Mbi bazën e sqarimeve të dhëna më lartë, paneli shqyrtues vlerëson se me këto rekomandime, paneli shqyrtues do të mund të konsiderojë ankesën e operatorit ekonomik ankues "Gent Gorani" B.I si e bazuar dhe ankesën Q.M "Tema" dhe të sigurojë një procedurë të rregullt dhe të drejtë të prokurimit publik duke kërkuar një gjë te tillë nga Autoriteti Kontraktues.

-Përfundim-

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, vlerëson se AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60 të LPP-së, andaj është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet ne harmoni te plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies, konform nenit 24.2 të LPP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **TELEKOMI I KOSOVËS SH.A., TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.**
- OE - **Q.M. "Tema", Gent Gorani**
- Arkivës së OSHP-së: